

Kompania e Sigurimeve Illyria sh.a.

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	3
Pasqyra e rrjedhës së parashë	4
Shënimet për pasqyrat financiare	5- 44
Shënimet plotësuese	45-48

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe menaxhmentin e Illyria Insurance sh.a

Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Illyria Insurance sh.a (më poshtë "Kompania"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Kompanisë më 31 dhjetor 2017, dhe rezultatin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Kompania në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likujdojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Menaxhmenti është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Kompania të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Illyria Insurance sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti tjetër mbi kërkesat rregullore të autoritetit mbikëqyrës, Bankës Qendrore të Kosovës, për Investime në Rezervat Teknike.

Në bazë të kërkesave të Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), ne kemi lexuar Shënime Plotësuese për Investimet në Rezervat Teknike ("Shënime Plotësuese"). Këto Shënime Plotësuese të përgatitura nga menaxhmenti nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare. Informacioni historik financiar, i paraqitur në Shënime Plotësuese të përgatitura nga menaxhmenti, është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me informacionin financiar vjetor të shpalosur në pasqyrat financiare të Kompanisë më 31 dhjetor 2017, të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të aplikueshme për kompanitë e sigurimeve në Kosovë. Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e Shënimeve Plotësuese, në përputhje me Rregulloren e BQK-së "Rregullore për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike si dhe investimin e kapitalit themeltar të siguruesve" të datës 29 dhjetor 2016.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo
Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k

23 shkurt 2018

Prishtinë, Kosovë


Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.


Pasqyra e pozicionit financiar

Më 31 dhjetor 2017 (vlerat në Euro)

	Shënim	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Pasuritë			
Prona dhe pajisjet	7	3,078,694	3,132,527
Pasuritë e paprekshme	8	63,546	60,406
Gjithsej pasuritë jo-qarkulluese		3,142,240	3,192,933
Investimet në letrat me vlerë të Qeverisë	9	4,185,932	3,861,898
Të arkëtueshmet nga agjentët dhe klientët	10	481,945	355,609
Pasuritë tjera	11	318,791	355,588
Pjesa e risiguruesve për detyrimet e siguruara	12	667,910	474,380
Kostot e përvetësuar të shtyra	13	453,143	427,719
Depozitat me afat	14	5,722,441	5,316,623
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	15	605,277	553,514
Gjithsej pasuritë		15,577,679	14,538,264
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	16	5,428,040	5,428,040
Teprica e rivlerësimit		884,329	765,843
Humbjet e akumuluar		(2,273,200)	(2,496,776)
Gjithsej ekuiteti		4,039,169	3,697,107
Detyrimet			
Detyrimet nga kontrata e sigurimit –Rezerva e dëmeve	17	7,428,559	7,342,027
Detyrimet nga kontrata e sigurimit- Primet e pa fituara	18	2,634,505	2,187,407
Të pagueshmet nga sigurimi	19	732,993	442,070
Të pagueshmet tjera	20	672,781	807,951
Të ardhurat e shtyra	21	69,672	61,702
Gjithsej detyrimet		11,538,510	10,841,157
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		15,577,679	14,538,264

Pasqyrat financiare të paraqitura në faqet 1 deri 48 janë miratuar për publikim më 22 shkurt 2018 nga:


Gianni Sokolic
Drejtör ekzekutiv


Primož Mocivnik
Kryetar i Bordit

Shënimet nga faqe 5 deri 44 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (vlerat në Euro)

	Shënim	2017	2016
Primet e shkruara bruto	22	8,298,476	7,120,933
Tatimi mbi primet		(414,924)	(356,090)
Ndryshimi në provizionin bruto për primet e pafituara	18	(447,098)	494,254
Primet e shkruara neto		7,436,454	7,259,097
Primet e ceduara ndaj risiguruesve	22	(791,677)	(763,672)
Pjesa e risiguruesve në ndryshimin e provizionit për primet e pafituara	12	68,659	25,366
Të ardhurat neto nga primet e sigurimit		6,713,436	6,520,791
Të ardhurat nga investimet	25	151,653	157,456
Kthimet nga risigurimi		1,011,935	415,656
Komisionet e risigurimit		127,374	111,773
Të ardhurat tjera	25	303,650	154,743
Gjithsej të ardhurat		8,308,048	7,360,419
Humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve		(4,473,663)	(4,059,424)
Shpenzimet e interesit		(7,843)	(7,923)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	23	(808,303)	(874,866)
Pjesa e shpenzimeve të BKS-së	24	(608,055)	(544,692)
Shpenzimet administrative	26	(2,186,608)	(2,045,484)
Gjithsej humbjet dhe shpenzimet		(8,084,472)	(7,532,389)
Fitimi neto për vitin		223,576	(171,970)
Të ardhurat tjera gjithpërfshirëse			
Të ardhurat tjera gjithpërfshirëse nga rivlerësimi i Letrave me Vlerë		118,486	12,450
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) gjithpërfshirëse për vitin		342,062	(159,520)

Shënimet nga faqe 5 deri 44 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (vlerat në Euro)

	Ekuiteti	Humbjet e akumuluar	Teprica nga rivlerësimi i pronës	Rezerva e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare në dispozicion për shitje	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2016	5,428,040	(2,324,806)	765,996	(12,603)	3,856,627
<i>Të ardhurat gjithpërfshirëse për vitin</i>					
Fitimi neto i periudhes	-	(171,970)	-	-	(171,970)
Ndryshimet e vlerës së drejtë për vitin	-	-	-	12,450	12,450
Gjithsej të ardhurat gjithpërfshirëse	-	(171,970)	-	12,450	(159,520)
Gjithsej transaksionet me aksionarët të raportuara direkt në ekuitet	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	5,428,040	(2,496,776)	765,996	(153)	3,697,107
<i>Të ardhurat gjithpërfshirëse për vitin</i>					
Fitimi neto i periudhes	-	223,576	-	-	223,576
Ndryshimet e vlerës së drejtë për vitin	-	-	-	118,486	118,486
Gjithsej të ardhurat gjithpërfshirëse	-	223,576	-	118,486	342,062
Gjithsej transaksionet me aksionarët të raportuara direkt në ekuitet	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	5,428,040	(2,273,200)	765,996	118,333	4,039,169

Shënimet nga faqe 5 deri 44 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Pasqyra e rrjedhës së parasë

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (vlerat në Euro)

	Shënim	2017	2016
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi neto i periudhës		223,576	(171,970)
<i>Rregullimet për të barazuar fitimin neto nga rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operative:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7,8	92,715	98,919
Zërat jo-monetarë në Pasqyrën e të Ardhurave	27	17,307	-
Rritja e detyrimeve nga kontrata e sigurimit	17	86,532	521,979
Rritja (zvogëlimi) në primin e pafituar	18	447,098	(494,254)
Shpenzimet e tatimin mbi primet		414,924	356,090
Shpenzimet e interesit		7,843	7,923
Humbja nga shlyrja e pasurive		501	8,085
Të ardhurat nga investimet	25	(151,653)	(157,456)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative		1,138,843	169,316
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>			
Zvogëlimi/(Rritja) në pjesën e risiguresve të detyrimeve nga sigurimi	12	(193,530)	14,630
Zvogëlimi/(Rritja) në të arkëtueshmet nga agjentë dhe klientët	10	27,530	168,415
Zvogëlimi/(Rritja) në kostot e përvetësuar të shtyra	13	(25,424)	50,399
(Rritja) në pasuritë tjera	11	36,796	(34,567)
Zvogëlimi/(Rritja) në të pagueshmet nga sigurimi	19	140,006	(56,195)
Rritja/(Zvogëlimi) në të pagueshmet tjera	20	(135,170)	39,806
Rritja/(Zvogëlimi) në të hyrat e shtyra	21	7,970	7,356
Rrjedha e parasë e gjeneruar nga aktivitetet operative		997,021	359,160
Tatimi mbi primet i paguar		(493,179)	(356,090)
Interesi i paguar		(7,843)	(7,923)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet operative		495,999	(4,853)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pasurive fikse	7,8	(45,659)	(38,620)
Të hyrat nga shitja e PPP	7,8	3,136	1,798
(Zvogëlimi)/Rritja e depozitave me afat	14	(400,000)	(1,536,211)
Interesi i pranuar		200,945	142,459
Investimet në Letrat me vlerë të Qeverisë	9	(202,657)	455,737
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(444,235)	(974,837)
Paraja neto nga aktivitetet financuese		-	-
Rritja/(zvogëlimi) i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		51,764	(979,690)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	15	553,513	1,533,203
Paraja dhe ekuivalentët e parasë më 31 dhjetor	15	605,277	553,513

Shënimet nga faqe 5 deri 44 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

1. NJËSIA RAPORTUESE

Kompania e Sigurimeve Illyria sh.a – e njohur më pare si Kompania e Sigurimeve Dukagjini sh.a (këtej e tutje referuar si “Illyria” ose “Kompania”) është themeluar më 6 mars 2002 sipas rregulloreve të UNMIK për regjistrim të përkohshëm të biznesit. Kompania operon sipas licencës së lëshuara më 13 shkurt 2002 nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), për të lëshuar polica të autopërgjegjësisë ndaj palëve të treta (PAPT) policave të sigurimit të automjeteve në territorin e Kosovës dhe po ashtu produkte të sigurimit vullnetar.

Kompania është pjesë e Save Re Group, kompani Sllovene.

Zyra qendrore e Kompanisë gjendet në Bulevardin Nënë Tereza nr.33 Prishtinë Kosovë. Më 31 dhjetor 2017, Kompania ka të punësuar 181 punonjës dhe (2016: 181 punonjës)

Numri i të punësuarve sipas shkallës së arsimit formal

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët	-	-
Arsimi i mesëm	91	106
Arsimi i lartë	28	23
Universitet	44	37
Master dhe doktoraturë	18	15
GJITHSEJ	181	181

2. BAZA E PËRGATITJES

a. Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Kompanisë janë përgatitur në përputhje me SNRF, siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Në zgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël, si dhe në përgatitjen e pasqyrave financiare, Bordi Mbikëqyrës i Kompanisë së Sigurimeve Illyria synon të sigurojë informata kontabël të kuptueshme, relevante, të besueshme dhe të krahasueshme.

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në supozimin e parimit të vijimësisë.

Pasqyrat financiare të konsoliduara të SAVA RE GROUP – Kompania mëmë mund ti gjeni në <http://www.sava-re.si/en/investors/financial-information/financial-reports/>.

b. Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur nën parimin e kostos historike, përveç instrumenteve financiare në dispozicion për shitje, të cilat janë matur me vlerën e drejtë.

c. Valuta funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare janë prezantuar në Euro (“Euro”) e cila është valuta funksionale dhe prezantuese e Kompanisë. Valuta funksionale e njësisë është valutë e mjedisit ekonomik primar në të cilin operon.

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)

d. Informacion krahasues

Për paraqitje më të qëndrueshme të transaksioneve, klasifikimi i disa zërave në informacionin krahasues financiar është ndryshuar për të qenë në përputhje me trajtimin e vitit aktual.

e. Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura bazohen në përvojën historike dhe faktorët e ndryshëm që besohet të jenë të arsyeshëm sipas rrethanave, rezultatet e të cilave formojnë bazën për të bërë gjykime në lidhje me vlerat kontabël të pasurive dhe detyrimeve të cilat nuk janë lehtësisht të dukshme nga burimet tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse rishikimi ndikon vetëm në atë periudhë ose në periudhën e rishikuar dhe periudhat e ardhshme nëse ndryshimi ndikon të dy periudhat aktuale dhe të ardhmen.

Supozimet dhe burimet e tjera të pasigurisë lidhen me vlerësimet që kërkojnë që menaxhmenti të bëjë gjykime të vështira, subjektive dhe komplekse. Më poshtë jepen fushat kryesore që përfshijnë gjykimin e menaxhmentit.

Rënia në vlerë e të arkëtueshmeve njihet në bazë të politikës kontabël të paraqitur në shënimin 10. Çdo humbje nga rënia në vlerë e njohur paraqitet në shënimin 10.

Investimet financiare: Klasifikimi, njohja, matja dhe ç'regjistrimi, si dhe zhvlerësimi i investimeve dhe matja e vlerës së drejtë bëhen në bazë të politikës kontabël të përcaktuar në shënimin 10. Lëvizjet në investimet dhe klasifikimi i tyre paraqiten në shënimin 9, ndërsa të ardhurat, shpenzimet dhe zhvlerësimi janë paraqitur në shënimin 26.

Provizionet teknike - llogaritjet dhe analiza e adekuatshmërisë së detyrimeve që lidhen me kontratat e sigurimit janë paraqitur në shënimin 17.

f. Pasqyra e rrjedhës së parasë

Pasqyra e rrjedhës së parasë është përgatitur duke përdorur metodën indirekte. Rrjedhjet e parasë nga aktivitetet operative janë përgatitur në bazë të dhënave të vitit 2017 të pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës së të ardhurave, me rregullimet e përshtatshme për zërat që nuk përbëjnë rrjedhje të parasë. Rrjedhjet e parasë nga aktivitetet financiare janë shpalosur bazuar në disbursimet aktuale. Zërat në lidhje me ndryshimet në pasuritë neto operative shpalosen në shumat neto.

g. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet tregon lëvizjet në përbërësit individual të ekuitetit gjatë vitit.

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

a. Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme shprehen me kosto, duke përfshirë çdo shpenzim që i atribuohet drejtpërdrejtë përgatitjes së tyre për përdorimin e tyre të synuar, minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga rënia në vlerë.

Amortizimi llogaritet për çdo zë në bazë të linjës së drejtë.

Pasuritë e paprekshme fillimisht amortizohen sipas disponueshmërisë së tyre për përdorim. Pasuritë e paprekshme në Kompani përfshijnë softuer kompjuterik, licenca që kanë të bëjnë me programet kompjuterike (jetëgjatësia e tyre supozohet të jetë 5 vite).

b. Prona dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet fillimisht njihen me kosto, duke përfshirë koston që i atribuohet drejtpërdrejt blerjes së pasurisë. Më pas aplikohet modeli i koston: pasuritë mbahen me kosto, minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi.

Prona dhe pajisjet zhvlerësohen së pari sipas disponueshmërisë së tyre për përdorim. Zhvlerësimi llogaritet për çdo zë veç e veç, në bazë të linjës së drejtë. Normat e zhvlerësimit përcaktohen në mënyrë që të lejojnë shlyrjen e koston së pronave dhe pajisjeve gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar.

Ndërtesat

Ndërtesat paraqiten me vlerën e rivlerësuar vlera e drejtë e të cilave matet në mënyrë të besueshme, vlerës së drejtë në datën e rivlerësimit i minusohet çdo zhvlerësim akumulues dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Rivlerësimet kryhen në baza të rregullta, çdo dy vite.

Normat e zhvlerësimit të pronave dhe pajisjeve:

Grupi i zhvlerësimit	Norma
Toka	0 %
Ndërtesat	1.3–2 %
Mjetet transportuese	15.5–20 %
Kompjuterët	33.0 %
Pajisje për zyre dhe mobilje	10–12.5 %
Pajisjet tjera	6.7–20 %

Kompania vlerëson çdo vit nëse ka ndonjë tregues të rënies në vlerë. Nëse ka, fillon procesin e vlerësimit të shumës së rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë e vlerës në përdorim dhe vlera e drejtë minus kostot e shitjes.

Nëse shuma e rikuperueshme tejkalon ose është e barabartë me vlerën kontabël, pasuria nuk ka rënë në vlerë.

Fitimet dhe humbjet nga shlyrjet e zërave të pronës dhe pajisjeve, të llogaritura si diferenca midis të ardhurave të shitjes dhe vlerave kontabël neto, përfshihen në fitim ose humbje. Kostot e mirëmbajtjes dhe riparimit të pronës dhe pajisjeve njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Investimet në prona dhe pajisjet që rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme njihen në vlerën e tyre kontabël.

c. Investimet financiare

Investimet financiare fillimisht njihen me kosto dhe vlera kontabël rritet ose zvogëlohet për të njohur fitimin ose humbjen e kompanisë pas datës kur investimi financiar është vlerësuar më së voni.

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

d. Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim

Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim janë pasuri me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturim fiks që Kompania mund dhe synon ti mbajë deri në maturim.

e. Pasuritë financiare në dispozicion për shitje

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje janë pasuritë që Kompania synon t'i mbajë për një periudhë të pa caktuar dhe nuk klasifikohen si pasuri financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose pasuri financiare të mbajtura deri në maturim.

f. Kreditë dhe të arkëtueshmet (depozitat)

Kjo kategori përfshin kreditë dhe depozitat bankare me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk tregtohen në asnjë treg aktiv.

Njohja, matja dhe ç'regjistrimi

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje dhe pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim fillimisht maten me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni. Blerjet dhe shitjet e pasurive financiare, kredive dhe depozitave njihen në datën e tregtimit. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga rivlerësimi i vlerës së drejtë të pasurive financiare në dispozicion për shitje njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse dhe transferohen në pasqyrën e të ardhurave pas shlyrjes ose rënies në vlerë. Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim maten me koston e amortizuar minus humbjet nga rënia në vlerë. Pasuritë financiare ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të rrjedhës së parasë nga pasuritë financiare ose kur transferohen pasuritë dhe transferimi kualifikohet për ç'regjistrim në përputhje me SNK 39. Kreditë dhe të arkëtueshmet (depozitat) dhe pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim maten me koston e amortizuar.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Kompania matë të gjitha instrumentet financiare me vlerën e drejtë, me përjashtim të depozitave, aksioneve që nuk janë të kuotuar në ndonjë treg të rregulluar, kredive dhe borxhit të varur (supozohet se vlera kontabël është një përafrim i arsyeshëm i vlerës së drejtë) dhe instrumentet financiare të mbajtura deri në maturim të cilat janë matur me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është çmimi që do të merret për të shitur një pasuri ose për të paguar transferimin e një detyrimi në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Matja e vlerës së drejtë bazohet në supozimin se transaksioni për të shitur pasurinë ose për të transferuar detyrimin kryhet ose (i) në tregun kryesor të pasurisë ose detyrimit, ose (ii) në mungesë të një tregu kryesor në tregun më të favorshëm për pasurinë ose detyrimin. Treguesi kryesor ose më i favorshëm duhet të jetë i arritshëm për kompaninë. Vlera e drejtë e një pasurie ose detyrimi matet duke përdorur supozimet se pjesëmarrësit e tregut, kur çmojnë pasurinë ose detyrimin, veprojnë në interesin e tyre më të mirë ekonomik. Një matje e vlerës së drejtë të një pasurie jofinanciare merr në konsideratë aftësinë e një pjesëmarrësi të tregut për të gjeneruar përfitime ekonomike duke përdorur pasurinë në përdorimin më të lartë dhe më të mirë të tij ose duke e shitur atë tek një pjesëmarrës tjetër i tregut që do të përdorte pasurinë në përdorimin e tij më të lartë dhe më të mirë.

Kompania përdor teknika të vlerësimit që janë të përshtatshme në rrethanat dhe për të cilat disponohen të dhëna të mjaftueshme për të matur vlerën e drejtë, duke maksimizuar përdorimin e inputeve të vëzhguara të disponueshme dhe duke minimizuar përdorimin e inputeve të pa vëzhguara.

g. Rënia në vlerë e investimeve

Një pasuri financiare e ndryshme nga vlera e drejtë ka rënie në vlerë nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe humbja e shkaktuar nga rënia në vlerë siguron që ka evidencë objektive të rënies në vlerë si rezultat i ngjarjeve të shkaktuara pas njohjes fillestare të pasurisë dhe se ngjarjet e tilla kanë ndikim në rrjedhën e ardhshme të parasë që mund të vlerësohen me besueshmëri. Grupi vlerëson nëse ka ndonjë dëshmi objektive që pasuritë individuale financiare janë zhvlerësuar në baza tre mujore (gjatë përgatitjes së raporteve të përkohshme dhe vjetore).

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

h. Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet përfshijnë të arkëtueshmet për primet nga mbajtësit e policave ose siguruesit si dhe të arkëtueshmet tjera.

Njohja e të arkëtueshmeve

Të arkëtueshmet fillimisht njihen në bazë të policave të lëshuara, faturave ose dokumenteve të tjera autentike. Në pasqyrat financiare, të arkëtueshmet raportohen në shuma neto, d.m.th neto nga çdo lejim i bërë.

Të arkëtueshmet e sigurimeve

Të arkëtueshmet e sigurimeve njihen kur duhet dhe maten në njohjen fillestare me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme. Pas njohjes fillestare, të arkëtueshmet e sigurimeve maten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Vlera kontabël e të arkëtueshmeve të sigurimit rishikohet për zhvlerësim sa herë që ngjarjet ose rrethanat tregojnë se vlera kontabël neto nuk mund të rikupërohet, me humbjen nga rënia në vlerë e regjistruar në pasqyrën e të ardhurave.

i. Rënia në vlerë e të arkëtueshmeve

Kompania klasifikon të arkëtueshmet me risk të ngjashëm kredie. Kompania vlerëson të arkëtueshmet në bazë të kushteve të rikuperimit ose rënies në vlerë, duke bërë lejet bazuara në historinë e pagesave. Vlerësimet individuale kryhen për të gjitha zërat e të arkëtueshmeve.

Përveç moshës, metoda për kontabilizimin e lejeve merr parasysh fazën e procedurës së mbledhjes dhe të dhënat historike mbi përqindjen e shlyerjeve të bëra dhe raportin e rikuperueshmërisë. Supozimet shqyrtohen çdo vit.

Të arkëtueshmet nga regreset njihen si pasuri vetëm nëse, në bazë të kërkesës së regreseve, ekziston një bazë e përshtatshme ligjore (një urdhër përfundimtar i lidhjes, një marrëveshje me shkrim ose pagesa nga mbajtësi i policës ose debitori). Njohja e shumave kryesore ndaj të cilave të arkëtueshmet nga regreset janë zvogëluar dëmet e paguara.

Pasuritë e risiguruara

Kompania cedon primet e sigurimit dhe riskun në rrjedhën normale të biznesit me potencial të humbjes neto përmes diversifikimit të riskut të saj. Pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat e ceduara të risiguruara paraqiten veçmas si pasuri dhe detyrim nga kontratat e sigurimeve, sepse marrëveshjet e risigurimit nuk e lirojnë Kompaninë nga detyrimi i drejtpërdrejtë ndaj mbajtësve të policave të saj. Politika e risigurimit të kompanisë është themeluar me qëllim që të kufizojë humbjet e mundshme të saja që rrjedhin nga ekspozimet më të gjata ndaj përgjegjësive ndaj palëve të treta motorike ("MTPL"), Sigurimet Kasko, Sigurimet e Pronës dhe detyrimet nga linjat e biznesit. Një risigurim i tillë përfshinë si bazë fakultative (pronën) ashtu edhe traktate, humbjet e tepërta (të pronës dhe ngarkesave) ose mbi bazën e tepricës dhe të kuotës. Vetëm të drejtat sipas kontratave që krijojnë një transferim të rëndësishëm të riskut të sigurimit llogariten si pasuri të risigurimit. Të drejtat sipas kontratave që nuk transferojnë riskun e rëndësishëm të sigurimit, llogariten si instrumente financiare.

Primet e risigurimit për cedim të risigurimit njihen si një shpenzim në mënyrë që të jetë në përputhje me bazën e njohjes së primeve për kontratat e lidhura të sigurimit. Për biznesin e sigurimit të përgjithshëm, primet e risigurimit janë shpenzuar gjatë periudhës kur mbulimi i risigurimit është siguruar në bazë të modelit të riskut të risiguruar. Pjesa e paspenzuar e primeve të risigurimit të ceduar është përfshirë në pasuritë e risigurimit. Shumat e njohura si pasuri të risigurimit maten në baza që është në përputhje me matjen e provizionit të mbajtur në lidhje me kontratat e lidhura të sigurimit. Të arkëtueshmet e risigurimeve përfshijnë komisionin e risigurimit në lidhje me premitë e ceduara ndaj risiguruesve dhe kthimet e paguara nga kompanitë e risigurimit në lidhje me dëmet e paguara. Këto janë klasifikuar si të arkëtueshme dhe janë shpalosur veçmas, nëse ka ndonjë.

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

i. Rënia në vlerë e të arkëtueshmeve (vazhdim)

Pasuritë e risiguruar vlerësohen për rënie në vlerë në çdo datë raportimi. Një pasuri konsiderohet se ka rënë në vlerë nëse ka prova objektive, si rezultat i një ngjarjeje që ka ndodhur pas njohjes së saj fillestare, që Kompania nuk mund të mbulojë të gjitha shumat dhe se ngjarja ka një ndikim të besueshëm të matshëm në shumat që Kompania do të marrë.

Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet e sigurimeve

Shumat për dhe nga mbajtësit e policave, agentët dhe risiguresit janë instrumente financiare dhe përfshihen në të arkëtueshmet dhe të pagueshmet e sigurimeve, dhe jo në provizione të kontratave të sigurimit ose pasurive të risigurimit.

j. Kostot e përvetësuara të shtyra

Kostot e përvetësuar që janë shtyrë përfshijnë pjesën e shpenzimeve operative që lidhen me politikën e lëshimit.

Kompania shpalos në kosto të përvetësuar të shtyra, kryesisht komisione të shtyra. Këto janë komisionet e rezervuara në lidhje me vitin e ardhshëm financiar dhe njihen në bazë të llogarive të (ri) sigurimit dhe vlerave të vlerësuar të fituara në bazë të komisioneve të vlerësuar duke marrë parasysh amortizimin e drejtpërdrejtë. Kompania shpalos në bazë të kostove të përvetësuar të shtyra, kryesisht komisionet e shtyra dhe tatimin mbi primet bruto.

k. Depozitat me afat

Depozitat me afat deklarohen në shumën e kryegjës së papaguar dhe klasifikohen sipas maturimit të tyre. Depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të parasë, ato me afat maturimi më të gjatë se tre muaj klasifikohen si depozita me afat. Interesi llogaritet në bazë akruale dhe interesat e arkëtueshme reflektohen në pasuri të tjera.

l. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përbëhen nga paraja në dorë, depozitat në bankë dhe investimet afatshkurtra me likuiditet të lartë me afat maturimi prej tre muajsh ose më pak kur janë blerë.

m. Ekuiteti

Përbërja:

- kapitali aksionar që përfshinë vlerën nominale të aksioneve të zakonshme të paguara të shprehura në Euro;
- kapitali rezervë përfshinë shumat që tejkalojnë vlerën nominal të aksioneve;
- fitimet e pashpërndara;
- neto fitimi/humbja për vitin

n. Klasifikimi i sigurimeve dhe kontratave të investimeve (detyrimet)

Kontratat sipas të cilave kompania pranon risk të rëndësishëm sigurimi nga një palë tjetër (mbajtësi i policës) duke rënë dakord të kompensojë mbajtësin e policës ndaj një ngjarje të caktuar të pasigurt në të ardhmen (ngjarja e siguar), e cila ndikon negativisht në të siguarin, klasifikohen si kontrata të sigurimit. Risku i sigurimit është risku i ndryshëm nga risku financiar. Risku financiar është risku i një ndryshimi të mundshëm në të ardhmen në një ose më shumë norma të interesit të specifikuar, çmimi i sigurisë, çmimi i mallrave, kursit të këmbimit, indeksit e çmimeve ose normave, vlerësimi i kredisë ose indeksi i kredisë ose ndryshoreve tjera jofinanciare kur ndryshorja nuk është specifike për një palë në kontratë.

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZDHIM)

n. Klasifikimi i sigurimeve dhe kontratave të investimeve(detyrimet) (vazhdim)

Kontratat sipas të cilave transferimi i riskut të sigurimit tek Kompania nga mbajtësi i policës nuk është i rëndësishëm, klasifikohen si kontrata investimi. Të gjitha kontratat aktualisht të lëshuara nga Kompania përfshijnë transferimin e riskut të rëndësishëm të sigurimit.

Kontratat e përgjithshme të sigurimit

Detyrimet e sigurimit llogariten ndaras për të gjitha produktet e sigurimit dhe përbëhen nga primet kontigjente (të pa fituara), risku kontigjent (i paskaduar) dhe humbjet kontigjente (të pa paguara në datën e mbylljes të vitit financiar).

Detyrimet e sigurimit (provizionet) përfaqësojnë vlerësimet e pagesave të ardhshme për dëmet e pa raportuara. Kompania nuk zbret detyrimet e saj të sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësimet reflektohet në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që merret me pasigurinë, duke kërkuar përdorimin e vlerësimeve të informuara dhe gjykimet.

Provizionet Teknike

Provizionet teknike janë paraqitur bruto në pasqyrën e pozicionit financiar. Pjesa e provizioneve teknike bruto për biznesin e ceduar ndaj risiguruesve të Kompanisë është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në pjesën e pasurisë të pjesës së risiguruesve të provizioneve teknike. Provizionet teknike për kompaninë miratohen nga një aktuar i certifikuar i caktuar nga kompania. Ato duhet të vendosen në një shumë që jep siguri të arsyeshme se detyrimet nga kontratat e supozuara (të reja) mund të përmbushen. Parimet kryesore të përdorura në llogaritjet janë përshkruar më poshtë.

Primet e pafituara

Primet e pafituara janë pjesët e primeve të pranura që kanë të bëjnë me periudhat pas periudhës së kontabilizimit. Primet e pafituara për sigurimin primar llogariten në baza pro rata temporis në nivelin e policës së sigurimit. Për risigurimet, të dhënat janë të disponueshme për llogaritjen e nivelit të policës së sigurimit.

Provizionet e dëmeve të papaguara

Provizionet e dëmeve të papaguara (provizionet e dëmeve) përcaktohen në shumën e detyrimeve të pritshme për dëmet e shkaktuara por të pa zgjidhura duke përfshirë shpenzimet për rregullimin e humbjeve. Këto përbëjnë provizionet për dëmet e raportuara të llogaritura në bazë të vlerësimeve të rasteve dhe dëmeve të shkaktuara por jo të raportuara (IBNR) të llogaritura duke përdorur metodat aktuariale. Detyrimet e ardhshme në përgjithësi nuk zbriten.

Provizionet për dëmet e shkaktuara, por të pa raportuara janë llogaritur për pjesën më të madhe të portofolios të siguruesve primar duke përdorur metoda aktuariale bazuar në trekëndëshat e dëmeve të paguara; rezultati është ofrimi i gjithsej provizionit të dëmeve dhe IBNR llogaritet si diferencë midis rezultatit të metodës së trekëndëshit dhe provizionit të bazuar në rezervat e rasteve. Në klasat ku vëllimi i biznesit nuk është mjaft i madh për rezultate të besueshme nga metodat e trekëndëshit, llogaritja bëhet në bazë të (i) produktit të numrit të pritshëm të dëmeve të raportuara më pas dhe shumës mesatare të dëmeve të raportuara më vonë ose (ii) bazuar në raportet e humbjeve të pritshme. Provizioni IBNR është përcaktuar në masën e vlerës së dëmeve të vlerësuara në këtë mënyrë.

Balanca e provizioneve të dëmeve të pa paguara është bërë duke u bazuar në të dhënat statistikore dhe duke përdorur metoda aktuariale. Prandaj, llogaritja e tij gjithashtu përbën një test të adekuatshmërisë së detyrimeve.

Provizionet tjera teknike

Provizionet tjera teknike përfshijnë vetëm provizionet për risqet e pa skaduar që rrjedhin nga testimi i adekuatshmërisë së detyrimeve të primeve të pafituara, siç përshkruhet më poshtë.

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZDHIM)

n. Klasifikimi i sigurimeve dhe kontratave të investimeve(detyrimet) (vazhdim)

Primet e pafituara janë primet e shtyra bazuar në periudhat e mbulimit. Nëse bazohet në një llogaritje të tillë, primi konsiderohet të jetë adekuat, primi i pafituar është gjithashtu adekuat. Kompania kryen teste të adekuatshmërisë së detyrimeve për primet e pafituara në nivelin e klasës së sigurimit. Llogaritja e raportit të kombinuar të pritur në çdo klasë të sigurimit bazohet në premitë e fituara, dëmet e shkaktuara, shpenzimet e komisioneve dhe shpenzimet e tjera operative. Kur raporti i kombinuar i llogaritur në këtë mënyrë tejkalon 100%, duke zbuluar kështu një mangësi në primin e pafituar, një dispozitë korresponduese për risqet e pashpjeguara brenda provizioneve të tjera teknike është lënë mënjanë, në përputhje me rregullat dhe rregulloret.

Vlerësimi i detyrimeve të kontratës së sigurimit

Kontratat e sigurimeve, janë bërë vlerësime si për koston përfundimtare të pritshme të dëmeve të raportuara në datën e raportimit dhe për koston përfundimtare të pritshme të dëmeve të shkaktuara, por jo të raportuara, në datën e raportimit (IBNR).

Ajo mund të marrë një periudhë të konsiderueshme kohe para se kostoja përfundimtare e dëmeve të mund të vendoset me siguri dhe për disa lloje të policave, IBNR dëmet përbëjnë shumicën e detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar shënimi 17 dhe shënimi përkatës i politikës kontabël 3.c (i) përmbajnë informacion në lidhje me supozimet dhe paqartësitë që lidhen me detyrimet e sigurimit.

Rezerva teknike për sigurimin kufitar dhe fondin e kompensimit

Rezervat teknike për sigurimin kufitar dhe fondin e kompensimit janë përgatitur në bazë të raporteve të ofruara nga Byroja, ndërsa raporti i auditorit të pavarur për Byronë Kosovare të Sigurimit ende nuk është lëshuar. Rrjedhimisht, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto shuma të raportuara në lidhje me transaksionet me Byronë Kosovare të Sigurimit.

o. Testi i adekuatshmërisë së detyrimeve (LAT)

Kompania kryen testimin e adekuatshmërisë së provizioneve në bazë të kontratave të sigurimit në datën e pasqyrave financiare për veprimtarinë jo-jetë.

p. Detyrimet

Detyrimet tregtare dhe shumat e tjera të pagueshme janë matur me kosto, që është vlera e drejtë e shumës që duhet paguar në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e marra, qoftë të faturuara për Kompaninë ose jo.

q. Provizion

Një provizion njihet kur Kompania ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i një ngjarjeje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke zbritur rrjedhet e ardhshme të parasë me normë tatimore. Provizioni reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe, kur është e përshtatshme, risqet specifike për detyrimin.

r. Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet e detyrueshme pensionale

Kompania paguan vetëm kontributet e detyrueshme pensionale që ofrojnë përfitime pensionale për punonjësit pas daljes në pension. Kontributet e kompanisë në planin pensional ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZDHIM)

r. Përfitimet e punonjësve (vazhdim)

(ii) Pushim vjetor me pagesë

Kompania njih si detyrim shumë të paskontuar të kostove të llogaritura lidhur me pushimin vjetor që pritët të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

s. Qiratë

Qiratë në të cilat një pjesë e konsiderueshme e risqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra sipas qirasë operative janë ngarkuar në fitim ose humbje në bazë të linjës së drejtë gjatë periudhës së qirasë.

t. Neto primet e fituara

Primet e fituara trajtohen në baza akruale, duke marrë parasysh çdo rritje të përfitimeve ekonomike në formën e hyrjeve në para ose rritjes së pasurisë. Më poshtë janë shpalosur veçmas: primet bruto të sigurimit, bashkë-sigurimit, risigurimet dhe primet e pafituara. Këto zëra përdoren për të llogaritur neto primet e fituara në pasqyrën e të ardhurave. Të hyrat njihen në bazë të llogarive të sigurimit të konfirmuara ose kontratave të sigurimit.

Vlerësimet bëhen në bazë të shumave në kontratat e sigurimit, të cilat sipas datave të skadimit, tashmë janë akumuluar edhe pse kompania ende nuk ka marrë llogari sigurimi. Neto primet e fituara llogariten në bazë të primeve të sigurimit bruto të faturuara, të pakësuar me primet e ceduara të faturuara, si për lëvizjen në primet bruto të pafituara dhe ndryshimin në pjesën e risiguresve në primet e pafituara. Primet e fituara vlerësohen në bazë të kontratave individuale të sigurimit.

u. Neto dëmet e shkaktuara

Dëmet dhe përfitimet e shkaktuara trajtohen në bazë akruale. Neto dëmet e shkaktuara përfshijnë neto dëmet bruto të paguara nga të arkëtueshmet nga regreset. Shuma e dëmeve bruto të shkaktuara ndikohet nga ndryshimi në provizionin e dëmeve, duke marrë parasysh dëmet e vlerësuar dhe provizionet për dëmet e papaguara. Vlerësimet bëhen në bazë të shumave në kontratat e sigurimit, të cilat sipas datave të skadimit, tashmë janë akumuluar edhe pse kompania ende nuk ka marrë llogari sigurimi.

Dëmet e shkaktuar përfshijnë kostot e zgjedhjes dhe të trajtimit të dëmeve të paguara dhe të pa paguara që rrjedhin nga ngjarjet që ndodhin gjatë vitit financiar së bashku me rregullimet e provizioneve të dëmeve të vitit të mëparshëm.

Dëmet e papaguara vlerësohen duke shqyrtuar dëmet individuale dhe duke bërë lejitimet për dëmet e shkaktuara por jo të raportuara, efektin e ngjarjeve të parashikueshme të brendshme dhe të jashtme, siç janë ndryshimet në procedurat e trajtimit të dëmeve, inflacioni, trendet gjyqësore, ndryshimet legjislative dhe përvojat e kaluara dhe tendencat. Rezervat për dëmet e papaguara nuk zbriten. Përshtatjet e provizioneve të dëmeve të vendosura në vitet e mëparshme pasqyrohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dhe shpalosen veçmas nëse janë materiale.

Përderisa Bordi i Drejtorëve konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet dhe rikthimet e risigurimeve përkatëse janë deklaruar në mënyrë të drejtë, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rezultat i informacioneve dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në rregullime të rëndësishme për shumat e dhëna. Përshtatjet në shumat e detyrimeve të sigurimit pasqyrohen në pasqyrat financiare për periudhën në të cilën bëhen rregullimet.

Kontigjentet për dëmet në procese ligjore

Një pjesë e konsiderueshme e dëmeve janë nën procese ligjore dhe për të cilat Kompania ka regjistruar detyrime të përshtatshme të sigurimit bazuar në vlerësimin e menaxhmentit.

Kompania e Sigurimeve Illyria Sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

(vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZDHIM)

v. Të ardhurat dhe shpenzimet nga investimet

Kompania regjistron të ardhurat nga investimet dhe shpenzimet veçmas sipas burimit të fondeve, që është veçmas për fondin e kapitalit, fondin e detyrimeve. Fondi i kapitalit përfshinë pasuritë që përfaqësojnë fondet e aksionarëve; fondi i detyrimeve përfshinë pasuritë që mbështesin provizionet teknike;

Të ardhurat nga investimet përfshijnë:

- të ardhurat nga interesi.
- të ardhurat nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe fitimet nga shitja e investimeve të përcaktuara me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- të ardhurat tjera.
- shpenzimet e investimeve.

Të ardhurat dhe shpenzimet e përmendura shpalosen në varësi të mënyrës se si klasifikohen investimet themelore, d.m.th investimet në dispozicion për shitje ose depozitat.

w. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative përbëhen nga:

- Kostot e blerjeve;
- Ndryshimi në kostot e shtyra të blerjeve;

